



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4617/4 prot.

Himarë, më 25.10.2023

PROCESVERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

PËR

“Dëgjese publike me banorët e njësisë Lukovë për projektbuxhetin e vitit 2024”

Njësia administrative	Data	Ora	Vendi ku zhvillohet dëgjesa	Struktura organizatore
Lukovë	25.10.2022	10.00	Borsh, Pranë “Freskia”	Drejtoriae financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritimit evropian

PJESËMARRJA

Nga Bashkia Himarë	Nga komuniteti	
Nënkryetari-Z.Pervin Gjiguria Administratori i njësisë Lukovë- Z.Andrea Boçi	Lista me pjesëmarrës bashkëngjitur	
Drejtori i drejtorisë së financës, të planifikimit të buxhetit dhe të integritimit evropian, z.Laert Mezani	_____	_____
Drejtor i shërbimeve publike-Z.Sokrat Kreku Drejtor i drejtorisë së të ardhurave-Z.Donald Bello	_____	_____
Specialistë të financës dhe të buxhetit të Bashkisë Himarë.	_____	_____
Sekretare këshilli bashkiak-znj.Elena Memushaj	_____	_____
Këshilltar Bashkiak-Z.Miltiadh Prifti Këshilltar Bashkiak-Z.Milto Nika Kryetarët e fshatrave	_____	_____

Të tjerë Deputet-z.Vullnet Sinaj	_____	_____
	_____	_____

- **Tematika për diskutim:**

- 1.Hartimi i paketës fiskale për vitin 2024
- 2.Problematika të hasura gjatë vitit 2023 me mbledhjen e taksave
- 3.Përshkrim i të ardhurave që do të jenë në dispozicion për parashikimin e investimeve
- 4.Sfidat që paraqiten në vjelje të taksave vjetore
- 5.Propozimet nga banorët e njësive.
- 5.Të tjera

- **Zhvillimi i dëgjësës**

1. U bë i qartë për pjesëmarrësit qëllimi i thirrjes për dëgjësë publike nga drejtori i drejtorisë së financës , z.Laert Mezani.
- 2.U vunë në pah probleme të evidentuara në territorin e bashkisë Himarë, të lidhura me nevojën për investime, gjatë viteve të fundit.
- 3.U sqarua dhe u argumentua në vija të përgjithshme rreth tarifave të parashikuara për paketën fiskale për vitin 2024.
- 4.U kalua në pyetje nga të pranishmit e në diskutime rreth projektbuxhetit dhe paketës fiskale për vitin 2024:

Paketa fiskale

Laert Mezani-Ju lutem neës keni sugjerime, mendime lidhur me taksat, dua një fitbeg nga ju.

Miltiadh Prifti- Ngaqë një pjesë e madhe e bizneseve janë familjare duhet ti ndihmojme në ceshtjen e taksave, tek pjesa e rrugeve dytësore të fshatrave të cilat ndikojnë në turizëm, restaurim, mirëmbajtje.

Fuat Mati- Menaxhim i sektorit të turizmit taksat janë koherente me nivelin e investimeve atje ku është bërë investim duhet të ketë diferencim mes nivelit taksash të ketë racionalitet midis të ardhurave të bizneseve. Një roje, një pastrues, ndricime, rrugë ne fshatin Sasaj, Ftterrë. Duhet të punësohen njerez sezonal nga Bashkia.

Donald Bello- Nuk mund të trajtojmë njësoj Borshin dhe Himarën në taksim. Taksa e fjetjes në hotel nuk është e njëjtë Himara me Dhërmiun dhe Borshin edhe për fshatrat ndryshon taksa kush është në vijë të parë trajtohet ndryshe se ai që është në vijën e dytë.

Milto Nika- Taksat në tërësi janë të larta. Taksapaguesit e vegjël i vret dicka tjetër se kemi të bëjmë hapje biznesi me leje, pa leje sot bizneset e vogla i vret taksa mbi sigurimet shoqërore e cila është shumë e lart. Lokalet e fshatrave nuk janë dakord për taksa duhet stimuluar. Lokalet sezonale nxjerrin shumë të ardhura dhe duhet të paguajnë taksa. Lokalet sezonale hapen pa dokumenta, biznesin e vogël e dëmtojnë ambulantët.

Taksa e tokës nuk është ndonjë taksë e lartë por taksa e tokës duhet të kthehet në investim për bujqësinë. Ndodhemi në zonën më të zhvilluar të bujqësisë dhe bujqësia është e paralizuar.

Blektoria , Bashkia Himarë nuk ka asnjë investim për blektorinë, duhet ti stimulojmë. Lukova është njësi më painvestuar dhe jemi taksapaguesit më të rregullt. Në lagjen Piqeras është prish një rruge dhe ashtu ka ngel. Në një lagje në Piqeras nuk ka fare ndricim duhet investim në rrugën e Bunecit.

Fuat Mati- Në Borsh kanali vaditës kërkojmë investim nga Bashkia.

Milto Nika- Bashkia duhet të cojë në dispozicion mjete si skrep dhe makinë vetshkarkuese në shërbim dhe mirëmbajten të rrugëve në njësinë Lukovë.

Kryeplaku Piqeras- Kërkojmë ndricim në fshatin Piqeras.

Miltiadh Prifti- Vëmendje të vecant duhet ti kushtojmë kanalizimeve në Lukovë hasim probleme me kanalin kryesor vaditës. Kërkojmë të marrim vëmendje fshatrat e njësisë Lukovë. Bashkia të nxjerrë kapacitet e saj në lidhje me shtyllat e ndricimit janë problem. Në lidhje me varrezat në Lukovë ata që ndërtojnë varrezat shkatërojnë të tjerat përreth, duhet menaxhuar të gjitha këto.

Loreta Isufi- Në vijën bregdetare në Borsh duhet investim, riparim në rrugën e plazhit e cila kufizon shumë në turizëm së bizneseve.

Xhevat Kasa- Në lagjen Grehot Lukovë është një rrugë që do investim

Afërtida Xhelili- Për zgjatjen e sezonit dhe ndalimin e punimeve. Unë do ti paguaj të gjitha taksat por dhe ju si Bashki keni detyrime kur ju trokasim në derë të na prisni. Afër subjekteve të bizneseve derdhen ujrat e zeza në det, ju lutem zgjidhje për këtë çështje.

Laert Mezani- Sezoni me VKM zgjat deri në 28 tetor.

Kërkesë nga shkolla e bashkuar “Qazim Pali”, Borsh nga senati i shkollës:

1-Banka dhe karrige për nënësit dhe mësuesat.

2-Laborator informatike, topa, rrjet volejboli.

3-Detergjent për pastrimin e shkollës.

Presidente senati: Enxhi Metaj

Drejtoresha e shkollës: Haide Dhuli

Kryetar I bordit dhe prindërve: Timoleo gërdhuqi.

Laert Mezani- Keni sugjerime për investime në zonat tuaja.

Stavri Boci- Në Borsh nuk ka vend në varreza duhet zgjerim varrezash në Lukovë dhe Borsh.Kanalet kulluese në Qazim Pali duhen pastruar dhe mirëmbajtur.

Deputet i zonës Vullnet Sinaj- Në radhë të pare ju falenderoj dhe gjëja që mbështes më shumë është biznesi. Dua të falendetoj këshillatrët e opozitës për infomacionet që më dhanë. Për varrezat cfarë problemi ka?

Sokrat Kreku- Jemi duke i mirëmbajtur me pastrues dhe cdo shërbim tjetër ne mirëmbajtje.

Disa nga kërkesat e sjellë nga deputeti i zonës Z.Vullnet Sinaj të cilët banorët e zonave ia kanë kërkuar:

1-Kanalizimi i ujërave për mos u mbytur pallatet në Nivicë.

2-Banorët e Fterës kërkojnë rrugën pëe ta shtruar Borsh-Fterrë.

3-Riparimin dhe shtrimin me cakëll të rrugës Corraj.

4-Kanalet vaditëse fshatrat Fterrë dhe Corraj.

5-Depo e ujit Corraj.

6- Dokumentat e tokës për fshatrat Corraj Fterrë, Sasaj.

- **Mbyllja**

U falënderuan pjesëmarrësit. U mblodhën nënshkrimet e pjesëmarrësve. U bë mbyllja e takimit.

MBAJTËS TE PROCESVERBALIT

SPECIALISTI I TRANSPARENCËS DHE I KOSULTIMIT PUBLIK

Erind Habili

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK

Elena Memushaj

Foto nga dëgjesa publike Njësia Administrative Lukovë më datë 25.10.2023





#25-10-2023.

Memo No.

Date

1 1 Mesia Lutave

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
----	----	----	----	----	----	----

Deqjese publike.

Liste prezenc.

- I. Emei Mbiemer
- I. Doneta Jufi
- Hereditq xhelisi
- Juliana Spiropoli
- Sokrat Kebe
- Al Shadh Reisi
- Ozhan Melicaj
- Fuqat Marku
- Angjela Bollaku
- Donatol Bello
- Ekriyan Hoxhy
- Rqilea Hoxhy
- Vrenistokli Loma
- Andi Kramci
- Stava Boc
- Xhevat Krasoj
- Perriu Gikuria
- Andea Peci
- Elena Memustaj
- Mito Niko